	vi) (SIC! v) difosfat dikalcium	Produkte ushqimore të thara pluhur Çokollatë dhe malt bulmeti-bazë për pije	10 g/kg 2 g/kg
	vii) (SIC! vi) dihidrogjen difosfat kalciumi	Pije alkoolike (me përjashtim të verës dhe birrës) Cereale për mëngjes Ushqime të shpejta	1 g/l 5 g/kg 5 g/kg
	Trifosfate	Surimi Peshk dhe pastë karkalecash	1 g/kg
	i)trifosfate pentanatrium	Shurup për kek, shurup i aromatizuar për qumësht të tundur dhe akullore; produkte të ngjashme Formula speciale për përdorimin e vlerave ushqimore të caktuara Lustrim për produkte mishi dhe perimesh	5 g/kg 3 g/kg 5 g/kg
E 452	ii)trifosfat pentakalium		5 g/kg
	Polifosfate	Sheqer pasticerie Krem ëmbëlsirash	4 g/kg
	i) polifosfate natriumi	Petë	5 g/kg
	ii) polifosfate kaliumi	Brumë i rrahur	10 g/kg
	iii) polifosfate kalciumi natriumi	Fileto peshku i papërpunuar, i ngrirë dhe me ngrirje të thellë Molusqe dhe karkaleca të papërpunuara dhe përpunuara të ngrira dhe me ngrirje të thellë Produkte patateje të përpunuara (që përfshin produkte të përpunuara të ngrira, me ngrirje të thellë, të freskëta dhe të thara) dhe patate të skuqura e me ngrirje të thellë Yndyra të shpërndarshme me përjashtim të gjalpfit Krem gjalpi i thartuar Produkte karkalecash të konservuara Spruco emulsionesh me bazë uji për mbështjelljen e formave pjekëse prej llamarine Pije me bazë kafe për automate me monedhë	2 g/kg 12g/kg 5g/kg 5g/kg 5g/kg 5g/kg 5 g/kg
E 468	iv)polifosfat kalciumi		2 g/kg 1 g/kg 30 g/kg
	Lidhje e kryqezuar e celulozës natrium metil karboksi		2 g/l
E 431	Stearate polioksietilene	Suplemente dietike të ngurta	30 g/kg
E 353	Acid metatartarik	Pro memoria	
		Verë në përputhje me rregulloren (KEE) nr.822/87, (KEE) nr.4252/88, (KEE) nr.2332/92 dhe (KEE) nr.1873/84 dhe rregulloret për implementimin e tyre	
		Verë e përgatitur	100 mg/l

E 355 E 356 E 357	Acid adipik Adipate natriumi Adipate kaliumi	Mbushës për produkte të pjekura mirë Ëmbëlsira të përziera të thara të pluhurosur Xhel-si ëmbëlsirë Fruta-ëmbëlsira të aromatizuara Pluhur për përgatitjen në shtëpi të pijeve	2 g/kg 1 g/kg 6 g/kg 1 g/kg 10 g/l e shprehur si acid adipik
E 363	Acid sucinik	Ëmbëlsira Supë dhe supë me lëng mishi Pluhur për përgatitjen në shtëpi të pijeve	6 g/kg 5 g/kg 3 g/l
E 385	Etilen diamine tetra acetat kalciumi dinatriumi (kalcium dinatrium EDTA)	Salca të emulsifikuara Bishtajore, leguminoze, angjinare dhe kërpudha të konservuara në kanaçe dhe shishe Molusqe dhe karkaleca të konservuara në kanaçe dhe shishe Peshk i konservuar në kanaçe dhe shishe Yndyrna të shpërndarshme si është përcaktuar në shtojcën B dhe C të rregullores (KE) nr.2991, që kanë përmbajtje yndyre 41% ose më pak Karkaleca të ngrira dhe me ngrirje të thellë	75 mg/kg 250 mg/kg 75 mg/kg 75 mg/kg 100 mg/kg 75 mg/kg
E 405	Propan-1, 2-diol alginat	Emulsione yndyre Produkte të pjekura mirë Mbushës dhe mbështjellës për produkte të pjekura mirë dhe ëmbëlsira Sheqer për pastičeri Ujë-bazë për akull të ngrënshëm Cereale dhe patate-bazë për ushqim të shpejtë Salca Birrë Çamçakiz Fruta dhe perime të përgatitura Pije të aromatizuara jo alkoolike Likere të emulsifikuara Ushqime dietetike të paracaktuara për qëllime të caktuara mjekësore-formula dietetike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një pjesë të ushqimit Suplemente ushqimore dietike Musht me përjashtim të cidre bouché	3 g/kg 2 g/kg 5 g/kg 1.5 g/kg 3 g/kg 3 g/kg 8 g/kg 100 mg/l 5 g/kg 5 g/kg 300 mg/l 10 g/l 1.2 g/kg 1 g/kg 100 mg/l
E 416	Gomë karaya	Cereale dhe patate-bazë për ushqim të shpejtë Stika të mbështjella Mbushës dhe mbështjellës për produkte të pjekura mirë Ëmbëlsira Salca të emulsifikuara Vezë-bazë për likere Ushqime suplemente dietike Çemçakëz	5 g/kg 10 g/kg 5 g/kg 6 g/kg 10 g/kg 10 g/l sasi e dëshirueshme 5 g/kg
E 420 E 421 E 953 E 965 E 966 E 967	Sorbitol (i)Sorbitol (ii)shurup sorbitoli Manitol Isomalt Maltitol (i)Maltitol (ii)Shurup maltitoli Laktitol Xylitol	Ushqime në përgjithësi (me përjashtim të pijeve dhe atyre produkteve ushqimore referuar në nenin 2(3)) Peshk, karkaleca, cefalopode dhe molusqe të ngrira dhe me ngrirje të thellë Likere	Sasi e dëshirueshme (për qëllime të tjera nga ëmbëlsues)

E 432	Polioksietilen sorbitan monolaurate (polisorbato 20)	Produkte të pjekura mirë Emulsione yndyre për qëllim pjekjeje Qumësht dhe krem analog	3 g/kg 10 g/kg 5 g/kg
E 433	Polioksietilen sorbitan monooleat (polisorbato 80)	Akull i ngrënëshëm Ëmbëlsira	1 g/kg 3 g/kg
E 434	Polioksietilen sorbitan monopalmitat (polisorbato 40) Polioksietilen sorbitan monostearat (polisorbato 60)	Sheqer pasticerie Salca të emulsifikuara Supë Çamçakëz Suplemente ushqimore dietike	1 g/kg 5 g/kg 1 g/kg 5 g/kg sasi e dëshirueshme
E 435	Polioksietilen sorbitan tristearat (polisorbato 65)	Ushqime dietike të paracaktuara për qëllime të caktuara mjekësore-formula dietetike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një ushqim individual.	1 g/kg individualisht ose të kombinuara
E 436			
E 442	Fosfat amoni	Kakao dhe produkte çokollate, duke përfshirë dhe mbushësit Produkte pasticerie bazuar në këto produkte	10 g/kg 10 g/kg
E 444	Sukroze acetat izobutirate	Pije të turbullta të aromatizuara joalkoolike Pije alkoolike të turbullta të aromatizuara që përmbajnë jo më pak se 15% alkool në volum	300 mg/l 300 mg/l
E 445	Estere gliceroli të kolofonit të drurit	Pije të turbullta të aromatizuara joalkoolike Trajtimi i sipërfaqeve të agrumeve	100 mg/l 50 mg/kg
E 473	Estere sukroze të acideve yndyrore	Kafe lëng e konservuar Produkte mishi të trajtuara termikisht Emulsione yndyre për qëllime pjekjeje Produkte të pjekura mire Pije të bardha Akull i ngrënëshëm Sheqer pasticerie Ëmbëlsira Salca Supë dhe supë me lëng mishi Fruta të freskëta, sipërfaqe e trajtuar Glikanxo, bazë për pije joalkoolike Pije joalkoolike me arrë kokosi dhe bajame Pije alkoolike, me përjashtim të birrës dhe verës Pudra për përgatitjen e pijeve të nxehta Bulmetra-bazë për pije Suplemente ushqimore dietike Ushqime dietike të paracaktuara për qëllime të caktuara mjekësore-formula dietetike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një pjesë të ushqimit Çamçakiz Analogë kremi Krem i sterilizuar dhe krem i sterilizuar me përmbajtje të reduktuar yndyre	1 g/l 5 g/kg (në yndyrë)
E 474	Sukrogliceride		10 g/kg 10 g/kg 10 g/kg 20 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 10 g/l 2 g/l sasi e dëshirueshme 5 g/l 5 g/l 5 g/l 5 g/l 10 g/l 5 g/l sasi e dëshirueshme 5 g/kg 10 g/kg individualisht ose i kombinuar 5 g/kg 5 g/kg
E 475	Estere poliglicerole të acideve yndyrore	<i>Produkte të pjekura mirë</i> <i>Likere të emulsifikuara</i> <i>Produkte veze</i> <i>Pije të bardha</i> <i>Çamçakiz</i> <i>Emulsione yndyrore</i> <i>Qumësht dhe analog kremi</i> <i>Sheqer pasticerie</i> <i>Ëmbëlsira</i> <i>Ushqime suplement dietike</i> <i>Ushqime dietike të paracaktuara për qëllime të</i>	10 g/kg 5 g/l 1 g/kg 0.5 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 2 g/kg 2 g/kg sasi e dëshirueshme 5 g/kg

		<i>caktuara mjekësore-formula dietike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një ushqim individual Granole-tip cereali për mëngjes</i>	10 g/kg
E 476	Poliglicerol poliricinoleat	Yndyra të shpërndarëshme me përmbajtje yndyre 41% ose më pak Produkte të ngjashme të shpërndarëshme me përmbajtje yndyrë më pak se 10% Salcë për sallatë Kakao-bazë për pastiçeri duke përfshirë dhe çokollatën	4 g/kg 4 g/kg 4 g/kg 5 g/kg
E 477	Estere propan-1,2-diol të acideve yndyrore	Produkte të pjekura mirë Emulsione yndyre për qëllim pjekjeje Qumësht dhe analog kremi Pije të bardha Akull i ngrënshtëm Sheqer pastiçerie Ëmbëlsira Ëmbëlsira me ajkë lart tjetër nga kremi Ushqime dietike të paracaktuara për qëllime të caktuara mjekësore-formula dietetike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një pjesë të ushqimit	5 g/kg 10 g/kg 5 g/kg 1 g/kg 3 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 30 g/kg 1 g/kg
E 479b	Vaj soje e oksiduar termikisht e ndërthurur me mono- dhe diglyceride të acideve yndyrore	Emulsione yndyre për qëllime skuqjeje	5 g/kg
E 481 E 482	Stearol-2-laktilat natriumi Stearol-2-laktilat kalciumi	Produkte të pjekura mirë Oriz që gatuhet shpejt Cereale për mëngjes Likere të emulsifikuara Pije alkoolike me më pak se 15% alkool në volum Cereale-bazë për ushqimet e shpejta Çamçakiz Emulsione yndyrë Ëmbëlsira Sheqer pastiçerie Pije të bardha Cereale dhe patate-bazë për ushqimet e shpejta Produkte mishi të grirë dhe copëtuara të konservuara Pudra për përgatitjen e pijeve të nxehta Ushqime dietike të paracaktuara për qëllime të caktuara mjekësore-formula dietetike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një pjesë të ushqimit Bukë (me përjashtim të atyre që i referohen shtojcës II) Mustardë frutash	5 g/kg 4 g/kg 5 g/kg 8 g/l 8 g/l 2 g/kg 2 g/kg 10 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 3 g/kg 5 g/kg 4 g/kg 2 g/l 2 g/kg 3 g/kg 2 g/kg individualisht ose i kombinuar
E 483	Tartrat stearil	Produkte të pjekura (me përjashtim të bukës referuar në shtojcën II) Ëmbëlsira	4 g/kg 5 g/kg
E 491 E 492 E 493 E 494 E 495	Sorbitan monostearat Sorbitan tristearat Sorbitan monolaurat Sorbitan monooleat Sorbitan monopalmitat	Produkte të pjekura mirë Mbështjellës për produkte të pjekura mirë Xhel marmalade Emulsione yndyre Qumësht dhe analog kremi Pije të bardha Koncentrat çaji të lëngshëm dhe lëng frutash dhe koncentrate erëzash	10 g/kg 5 g/kg 25 mg/kg(1) 10 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 0.5 g/kg

		Akull i ngrënshtëm Ëmbëlsira Sheqer pasticerie Kakao-bazë për pastiçeri, duke përfshirë çokollatë Salcë e emulsifikuar Suplemente ushqimore dietike Maja për pjekje Çamçakiz Ushqime dietike të paracaktuara për qëllime të caktuara mjekësore-formula dietetike për kontrollin e peshës të paracaktuara për të zëvendësuar të gjithë ushqimin ditor ose një ushqim individualë Pro memoria Vera	0.5 g/kg 5 g/kg 5 g/kg 10 g/kg(1) 5 g/kg sasi e dëshirueshme sasi e dëshirueshme 5 g/kg 5 g/kg individualisht ose të kombinuara
E 512	Klorur stannous	Asparagus i bardhë i konservuar në kanaçe dhe shishe	25 mg/kg si Sn
E 520 E 521 E 522 E 523	Sulfat alumini Sulfat alumin natrium Sulfat kalium alumin Sulfat amonium alumin	E bardhë vezë Fruta dhe perime të karamelizuara, kristalizuara dhe sheqerosura	30 mg/kg 200 mg/kg individualisht ose e kombinuar, e shprehur si alumin
E 541	Fosfat alumin natrium, acidik	Produkte të pjekura mirë (vetëm produkteve kulaçi dhe sfungjeri)	1 g/kg e shprehur si alumin
E 535 E 536 E 538	Ferrocianide natriumi Ferrocianide kaliumi Ferrocianide kalciumi	Kripa dhe zëvendësuesit e tij	Individualisht ose të kombinuara, 20 mg/kg si anhidrit ferrocianid kaliumi
E 551 E 552 E 553a E 553b E 554 E 555 E 556 E 559	Duoksid silikoni Silikat kalciumi (i)silikat magnezi (ii)trisolikat magnezi Talk Silikat alumin natrium Silikat alumin kalium Silikat alumin kalcium Silikat alumini (kaolin)	Produkte ushqimore të thara të pluhurosura (duke përfshirë sheqerin) Kripa dhe zëvendësuesit e tij Suplemente ushqimore dietike Produkte ushqimore në formë tablete dhe produkte ushqimore në formë tablete të mbështjella Djathë i përpunuar i prerë ose i grirë hollë, gjysmë hollë Analoge djathi i prerë ose i grirë hollë dhe analogë djathi i përpunuar Çamçakiz Oriz Sallam (vetëm më sipërfaqe të trajtuar) Erëza Pastiçeri, duke përfshirë dhe çokollatat (vetëm me sipërfaqe të trajtuar) Produkte yndyrore në kanaçe	10 g/kg 10 g/kg sasi e dëshirueshme sasi e dëshirueshme 10 g/kg sasi e dëshirueshme (vetem E 553b) 30 g/kg sasi e dëshirueshme 30 g/kg
E 579 E 585	Glukonat hekuri Laktat hekuri	Ullinj të errësuar nga oksidimi	150 mg/kg si hekur
E 620 E 621 E 622 E 623 E 624 E 625	Acid glutamik Glutamat mononatrium Glutamat monokalium Diglutamat kalciumi Glutamat monoamonium Diglutamat magnezi E 625	Produkte ushqimore në përgjithësi (me përjashtim të atyre të referuara në nenin 2(3)) Piper dhe erëza	10 g/kg individualisht ose të kombinuara Sasi e dëshirueshme
E 626 E 627 E 628 E 629	Acid gualinik Guanilat dinatrium Guanilat dikalium Guanilat kalciumi	Produkte ushqimore në përgjithësi (me përjashtim të atyre të nenit 2(3))	500 mg/kg individualisht ose të kombinuara, e

E 630 E 631 E 632 E 633 E 634 E 635	Acid inosinik Inosinat dinatrium Inosinat dikaliumi Inosinat kalciumi Kalcium 54-ribonukleotide Dinatrium 54-ribonukleotide	Erëza dhe piper Erëza dhe piper	shprehur si acid guanilik Sasi e dëshirueshme
E 900	Dimetil polisiloksan	Recel, xhel, marmalad dhe fruta të ngjashme të shpërndarshme, duke përfshirë produkte me kalori të ulët Supa dhe supa me lëng mishi Vajra dhe yndyrna për skuqje Pasticeri (me përjashtim të çokollatave) Pije të aromatizuara joalkoolike Lëng ananasi Fruta dhe perime të konservuara në kanaçe dhe shishe Çamçakiz Pro memoria për verën Sød . . . saft Brumë Verë mushti duke përjashtuar mushtin	10 mg/kg 10 mg/kg 10 mg/kg 10 mg/kg 10 mg/l 10 mg/l 10 mg/kg 100 mg/kg 10 mg/l 10 mg/kg 10 mg/l
E 901 E 902 E 903 E 904	Dyllë blete, e bardhe dhe e verdhë Dyllë candelilla Dyllë carnauba Llak	Si agjent shkëlqyes vetëm për: -pasticeri (duke përfshirë çokollatë) -produkte të vogla të produkteve të pjekura mirë të veshura me çokollatë -ushqime të shpejta -stika -kafe bishtajore	Sasi e dëshirueshme
		Suplemente ushqimore dietike	Sasi e dëshirueshme
		Agrume të freskëta, pjepër, mollë dhe dardha (sipërfaqe të trajtuara vetëm)	Sasi e dëshirueshme
		Pjeshkë dhe ananas (vetëm me sipërfaqe të trajtuar)	Sasi e dëshirueshme
E 905	Dyllë mikrokristalin	Sipërfaqe e trajtuar e: -pasticeri me përjashtim të çokollatës -çamçakiz -pjepër, papaja, mango, avogadro	Sasi e dëshirueshme
E 912 E 914	Estere të acidit montan Dyllë polietileni i oksiduar	Agrume të freskëta (vetëm me sipërfaqe të trajtuar) pjepër, mango, avogadro dhe ananas të fresket (vetëm me sipërfaqe të trajtuar)	Sasi e dëshirueshme Sasi e dëshirueshme
E 927b	Karbamide	Çamçakiz pa sheqer të shtuar	30 g/kg
E 950 E 951 E 957	K-acesulfame Aspartame Thaumatina	Çamçakiz me sheqer të shtuar	800 mg/kg 2500 mg/kg 10 mg/kg (vetëm si shtues i aromës) (Nqs E 950, E 951, E 957 dhe E 959 janë përdorur të kombinuara në çamçakiz, niveli maksimal i secili është reduktuar proporcionalisht)
		Ujë – bazë për pijet joalkoolike të aromatizuara Ëmbëlsirat-me qumësht dhe pa qumësht	0.5 mg/l 5 mg/kg (vetëm si shtues i aromës)
E 959	DC neohesperidine	Çamçakiz me sheqer të shtuar Yndyra të shpërndarshme Produkte mishi Xhel frutash Proteina bimore	150 mg/kg 5 mg/kg 5 mg/kg (vetëm si shtues i aromës Nqs E 950, E 951, E

			957 dhe E 959 janë përdorur të kombinuara në çamçakiz, niveli maksimal i secilit është reduktuar propocionalisht)
E 999	Ekstrakt quillaia	Ujë – bazë për pijet joalkoolike të aromatizuara	200 mg/l e llogaritur si ekstrakt anhidruës
		Verë mushi duke përjashtuar mushtin	200 mg/l e llogaritur si ekstrakt anhidruës
E 1201	Polivinilpirrolidone	Suplemente ushqimore dietike në tableta ose tableta të veshura	Sasi e dëshirueshme
E 1202	Polivinilpolipirrolidone		
E 1505	Citrat trietil		Sasi e dëshirueshme
E 1518	Triacetat gliceril (triacetin)	Çamçakiz	Sasi e dëshirueshme
E 459	Beta-ciklodekstrin	Produkte ushqimore në tableta ose tableta të veshura	Sasi e dëshirueshme
E 425	Konjak (i)gomë konjak (ii)glukomanane konjak	Produkte ushqimore në përgjithësi (me përjashtim të atyre të referuara në nenin 2(3))	10 g/kg individualisht ose të kombinuara

(1) vetëm E 493

SHTOJCA V MBARTËSIT DHE TRETËSIT MBARTËS TË LEJUAR

Shënim.

Nuk përfshihen në këtë listë:

1. Substancat që në përgjithësi konsiderohen si produkte ushqimore;
2. Substancat e referuara në nenin 1(5);
3. Substancat që kanë primar një acid ose funksion rregullator acid, të tilla si acid citrik dhe hidroksid amoni.

E Nr.	Emri	Përdorim i kufizuar
	Propan-1,2-diol (propilen glikol)	Ngjyruës, emulsifikues, antioksidant dhe enzima (maksimumi 1 g/kg në produkte ushqimore)
E 422	Glicerol	
E 420	Sorbitol	
E 421	Manitol	
E 953	Isomalt	
E 965	Maltitol	
E 966	Laktitol	
E 967	Xylitol	
E 400-404	Acid alginik dhe kripërat e tij të natriumit, kaliumit, kalciumit dhe amonit	
E 405	Propan-1,2-diol alginat	
E 406	Agar	
E 407	Karragen	
E 410	Gomë bishtajore	
E 412	Gomë guar	
E 413	Tragacanth	
E 414	Gomë akacie (gome arabie)	
E 415	Gomë xanthan	
E 440	Pektina	

E 432 E 433 E 434 E 435 E 436	Polioxyetilen sorbitan monolauratë (polisorbate 20) Polioxyetilen sorbitan monooleat (polisorbate 80) Polioxyetilen sorbitan monopalmitat (polisorbate 40) Polioxyetilen sorbitan monostearat (polisorbate 60) Polioxyetilen sorbitan tristearat (polisorbate 65)	Agjentë antishkumbues
E 442	Fosfat amoni	antioksidant
E 460 E 461 E 463 E 464 E 465 E 466	Celulozë (mikrokristalinë ose pluhur) Metil celuloze Hidroksipropil celulozë Hidroksipropil metil celulozë Etil metil celulozë Karboksi metil celulozë Natrium karboksi metil celulozë	
E 322 E 432-436 E 470b E 471 E 472a E 472c E 472e E 473 E 475 E 491 E 492 E 493 E 494 E 495	Lecitina Polisorbate 20, 40, 60, 65 dhe 80 Kripëra të magnezit të acideve yndyrore Mon- dhe digliceride të acideve yndyrore Estere të acidit acetil të mono- dhe diglicerideve të acideve yndyrore Estere të acidit citrik të mono- dhe diglicerideve të acideve yndyrore Estere të acidit tartarik mono- dhe diacetil të mono- dhe diglicerideve të acideve yndyrore Estere sukroze të acideve yndyrore Estere poliglicerole të acideve yndyrore Sorbitan monostearat Sorbitan tristearat Sorbitan monolaurate Sorbitan monooleat Sorbitan monopalmitat	Ngjyrues dhe Antioksidantë të tretshëm Në yndyrna Ngjyrues dhe agjentë shkumbues
E 1404 E 1410 E 1412 E 1413 E 1414 E 1420 E 1422 E 1440 E 1442 E 1450	Amidon i oksiduar Monoamidon fosfat Diamidon fosfat Diamidon fosfat i fosftuar Diamidon fosfat i acetiluar Amidon e acetiluar Diamidon adipat i acetiluar Hidroksi propil amidon Hidroksi propil amidon fosfat Sucinat octeni natrium amidon	
E 170 E 263 E 331 E 332 E 341 E 501 E 504 E 508 E 509 E 511 E 514 E 515 E 516 E 517	Karbonat kalciumi Acetat kalciumi Citrat natriumi Citrat kaliumi Fosfat kalciumi Karbonat kaliumi Karbonat magnezi Klorur kaliumi Klorur kalciumi Klorur magnezi Sulfat natriumi Sulfat kaliumi Sulfat kalciumi Sulfat amoni	
E 577 E 640 E 1505 E 1518	Glukonat kaliumi Glicinë dhe kripa e tij e natriumit Trietil citrat Gliceril triacetat (triacetin)	
E 551 E 552	Dioksid silikon Silikat kalciumi	Emulsifikues dhe ngjyrues, max.5%
E 553b E 558	Talk Bentonite	Ngjyrues, max.5%

E 559	Silikat alumini (kaolin)	
E 901	Dyll blete	Ngjyrues
E 1200	Polidektros	
E 1201 E 1202	Polivinilpirrolidone polivinilpolipirrolidone	Ëmbëlsues
E 322 E 432-436 E 470a E 471 E 491-495 E 570 E 900	Lecitine Polisorbate Kripëra të natrium, kalium dhe kalcium të acideve yndyrore Mono dhe digliceride të acideve yndyrore Sorbitane Acide yndyrore Dimetilpolisiloksan	Agjentë shkëlqyes për fruta
	Polietilenglikol 6000	Ëmbëlsues
E 425	Konjak (i)gome-konjak (ii)konjak-glukomane	
E 459	Beta-ciklodekstrinë	1 g/kg
E 1451	Amidon i oksiduar i acetiluar	
E 468	Lidhje e ndërthurur e natrium karboksi metil celulozë	Ëmbëlsues
E 469	Karboksi metil celulozë e hidrolizuar enzimatisht	

SHTOJCA VI

ADITIVËT USHQIMORË TË LEJUAR NË USHQIME PËR BEBE DHE FËMIJË TË VEGJËL

Shënim.

Formulat dhe produktet ushqimore për bebe dhe fëmijë të vegjël mund të përmbajnë E 414 (gomë akacie, gomë arabie) dhe E 551 (dyoksid silikoni) që rezultojn nga shtimi i ushqyesve të përgatitur që përmbajnë jo më shumë se 150 g/kg të E 414 dhe 10 g/kg të E 551, si dhe E 421 (manitol) kur përdoret si mbartës për vitaminën B12 (jo më pak se një pjesë vitaminë B12 për 1000 pjesë manitol). Sasia e E 414 në produktin e gatshëm për konsum nuk duhet të jetë më shumë se 10 mg/kg.

Formula dhe ushqimet për heqjen e gjirit për bebe dhe fëmijë të vegjël mund të përmbajnë E 301 (natrium L-askorbat), i përdorur si niveli SD (sasi e dëshirueshme) në mbështjelljen e ushqyesve të përgatitur që përmbajnë acide yndyrore më shumë lidhje dyfishe të pangopura. Sasia e E 301 në produktin e gatshëm për konsum nuk duhet të jetë më shumë se 75 mg/l.

Nivelet maksimale të përdorura në produktet ushqimore të gatshme për konsum duhet të përgatiten duke ndjekur instruksionet e prodhuesit.

PJESA I

ADITIVËT USHQIMORË TË LEJUAR NË FORMULAT PËR FËMIJË ME SHËNDET TË MIRË

Shënim.

1. Për prodhimin e qumështit të acidifikuar mund të përdoret kulturë e prodhuar e acidit jo patogen L(+)-laktik

2. Në qoftë se më shumë se një substancë E 322, E 471, E 472C dhe E 473 është shtuar në një produkt ushqimor, niveli maksimal i vendosur për atë produkt ushqimor për secilin nga këto substanca është më i ulët se pjesa relative e pranishme e të gjitha substancave, së bashku në atë produkt ushqimor.

E Nr.	Emri	Niveli maksimal
E 270	Acid laktik (vetëm forma L(+)-)	Sasi e dëshirueshme
E 330	Acid citric	Sasi e dëshirueshme
E 338	Acid fosforik	
E 306	Ekstrakt tokoferol i pasur	10 mg/kg individualisht ose të kombinuar
E 307	Alfa-tokoferol	
E 308	Gama-tokoferol	
E 309	Delta-tokoferol	
E 322	Lecitine	1 g/l
E 471	Mono- dhe digliceride	4 g/l
E 304	Palmitat L-askorbil	10 mg/l
E 331	Citrat natriumi	2 g/l
E 332	Citrat kaliumi	individualisht ose të kombinuar
E 339	Fosfat natriumi	1 g/l e shprehur si P ₂ O ₅
E 340	Fosfat kaliumi	individualisht ose e kombinuar
E 412	Gomë guar	1 g/l, kur produkti i lëngët përmban pjesërisht proteina të hidrolizuara
E 472c	Estere të acidit citrik të mono- dhe digliceride të acideve yndyrore	7.5 g/l e shitur si pudër 9 g/l e shitur si lëng kur produkti përmban pjesërisht proteina të hidrolizuara, peptide ose aminoacide.
E 473	Estere të sukrozës së acideve yndyrore	120 mg/l në produktet që përmbajnë proteina të hidrolizuara, peptide ose aminoacide

PJESA II
ADITIVËT USHQIMORË TË LEJUAR NË FORMULAT QË VIJOJNË PËR FËMIJË ME SHËNDET TË MIRË

Shënim.

1. Për prodhimin e qumështit të acidifikuar mund të përdoret kulturë e prodhuar e acidit jo patogen L(+)-laktik.

2. Në qoftë se më shumë se një substancë E 322, E 471, E 472C dhe E 473 është shtuar në një produkt ushqimor, niveli maksimal i vendosur për atë produkt ushqimor për secilin nga këto substanca është më i ulët se pjesa relative e pranishme e të gjitha substancave së bashku në atë produkt ushqimor.

3. Në qoftë se më shumë se një substancë E 407, E 410 dhe E 412 është shtuar në një produkt ushqimor, niveli maksimal i vendosur për atë produkt ushqimor për secilin nga këto substanca është më i ulët se pjesa relative e pranishme e të gjitha substancave, së bashku në atë produkt ushqimor.

E Nr.	Emri	Niveli maksimal
E 270	Acid laktik (vetëm forma L(+)-)	Sasi e dëshirueshme
E 330	Acid citric	Sasi e dëshirueshme
E 306	Ekstrakt tokoferol i pasur	10 mg/kg individualisht ose e kombinuar
E 307	Alfa-tokoferol	
E 308	Gama-tokoferol	
E 309	Delta-tokoferol	
E 338	Acid fosforik	
E 440	Pektina	5 g/l vetëm në formula të acidifikuara
E 322	Lecitina	1 g/l
E 471	Mon- dhe digliceride	4 g/l
E 407	Karragenan	0.3 g/l
E 410	Gomë bishtajore	1 g/l
E 412	Gomë guar	1 g/l
E 304	Palmitat L-askorbik	10 mg/l
E 331	Citrat natriumi	2 g/l
E 332	Citrat kaliumi	individualisht ose të kombinuara
E 339	Fosfat natriumi	1 g/l e shprehur si P ₂ O ₅
E 340	Fosfat kaliumi	individualisht ose e kombinuar

E 472c	Estere të acidit citrik të mono- dhe digliceride të acideve yndyrore	7.5 g/l e shitur si pudër 9 g/l e shitur si lëng kur produkti përmban pjesërisht proteina të hidrolizuara, peptide ose aminoacide.
E 473	Estere të sukrozes se acideve yndyrore	120 mg/l në produktet që përmbajnë proteina të hidrolizuara, peptide ose aminoacide

PJESA III

ADITIVËT USHQIMORË TË LEJUAR NË USHQIMET PËR HEQJEN E GJIRIT NË BEBE DHE FËMIJË TË VEGJËL ME SHËNDET TË MIRË

E Nr.	Emri	Produkti ushqimor	Niveli maksimal
E 170 E 260 E 261 E 262 E 263 E 270 E 296 E 325 E 326 E 327 E 330 E 331 E 332 E 333 E 507 E 524 E 525 E 526	Karbonat kalciumi Acid acetik Acetat kaliumi Acetat natriumi Acetat kalciumi Acid laktik Acid malik Laktat natriumi Laktat kaliumi Laktat kalciumi Acid citrik Citrat natriumi Citrat kaliumi Citrat kalciumi Acid klorhidrik Hidroksid natriumi Hidroksid kaliumi Hidroksid kalciumi	Ushqime për lënien e gjirit	Sasi e dëshirueshme (vetëm për pH të përshtatur)
E 500 E 501 E 503	Karbonat natriumi Karbonat kaliumi Karbonat amoni	Ushqime për lënien e gjirit	Sasi e dëshirueshme (vetëm si agjent fryrës)
E 300 E 301 E 302	Acid L- askorbik L-askorbat natriumi L-askorbat kalciumi	Fruta dhe perime, bazë për pije, lëngje dhe ushqime për fëmijë Cereale me përmbajtje yndyre-bazë për ushqime duke përfshirë biskota dhe peksimadhe	Individualisht ose të kombinuara, të shprehura si acid askorbik 0.3 g/kg 0.2 g/kg
E 304 E 306 E 307 E 308 E 309	Palmitat L-askorbil Ekstrakt tokoferoli i pasur Alfa tokoferol Gama tokoferol Delta tokoferol	Cereale me përmbajtje yndyre, biskota, peksimadhe dhe ushqime për fëmijë	0.1 g/kg individualisht ose të kombinuara
E 338	Acid fosforik	Ushqime për lënien e gjirit	1 g/kg si P ₂ O ₅
E 339 E 340 E 341	Fosfat natriumi Fosfat kaliumi Fosfat kalciumi	Cereale	1 g/kg individualisht ose e kombinuar, e shprehur si P ₂ O ₅
E 322	Lecitina	Biskota dhe peksimadhe Ushqime me bazë cereale Ushqime për fëmijë	10 g/kg
E 471 E 472a E 472b	Mono-dhe digliceride të acideve yndyrore Estere të acidit acetik të mono-dhe diglicerideve të acideve yndyrore Estere të acidit laktik të mono-dhe diglicerideve të acideve	Biskota dhe peksimadhe Ushqime me bazë cereale Ushqime për fëmijë	5 g/kg individualisht ose të kombinuara

E 472c	yndyrore Estere të acidit citrik të mono- dhe diglicerideve të acideve yndyrore		
E 400 E 401 E 402 E 404	Acid alginik Alginat natriumi Alginat kaliumi Alginat kalciumi	Ëmbëlsira Puding	0.5 g/kg individualisht ose të kombinuara
E 410 E 412 E 414 E 415 E 440	Gome bishtajore Gome guar Gome akacie Gome xanthan Pektina	Ushqime për lënien e gjirit Cereale pa gluten-bazë për ushqime	10 g/kg individualisht ose të kombinuara 20 g/kg individualisht ose të kombinuara
E 551	Dyoksid silikoni	Cereale të thara	2 g/kg
E 334 E 335 E 336 E 354 E 450a E 575	Acid tartarik Tartrat natriumi Tartrat kaliumi Tartrat kalciumi Difosfat dinatriumi Glukono-delta-laktone	Biskota dhe peksimadhe	5 g/kg si mbetje
E 1404 E 1410 E 1412 E 1413 E 1414 E 1420 E 1422 E 1450	Amidon i oksiduar Fosfat monoamidon Fosfat diamidon Fosfat diamidon i fosfuar Fosfat diamidon i acetiluar Amidon i acetiluar Adipate diamidon i acetiluar Sukinat oktenil natrium amidon	Ushqime për lënien e gjirit	50 g/kg
E 333	Citrat kalciumi	Në produkte me fruta me përmbajtje të ulët sheqeri	Sasi e dëshirueshme
E 341	Fosfat trikalium	Në ëmbëlsira me bazë fruta	1 g/kg si P ₂ O ₅
E 1451	Amidon i oksiduar i acetiluar	Ushqime për lënien e gjirit	50 g/kg

PJESA IV
ADITIVËT USHQIMORË TË LEJUAR NË USHQIME PËR BEBE DHE FËMIJË TË VEGJËL
PËR QËLLIME TË CAKTUARA MJEKËSORE

Janë zbatuar tabelat e pjesës 1 deri ne 3 të shtojcës VI

E Nr	Emri	Niveli maksimal	Kushtet specifike
E 401	Alginat natriumi	1 g/l	Nga katër muaj e lart në produkte ushqimore të veçanta me përbërje të adoptuar, e kërkuar për çrregullime metabolike dhe për kanalet ushqyese në përgjithësi
E 405	Propan 1,2-diialginat	200 mg/l	Nga 12 muaj e lart në dieta të veçanta të përcaktuara për fëmijë të vegjël të cilët kanë intolerancë nga qumështi i lopës ose gabime të lindura të metabolizmit
E 410	Gomë bishtajore	10 g/l	Nga lindja e më tutje në produkte për reduktimin e reflukseve gastro-esofagel
E 412	Gomë guar	10 g/l	Nga lindja e më tutje në produktet e formulave të lëngëta që përmbajnë proteina të hidrolizuara, peptide ose aminoacide
E 415	Gomë xanthan	1.2 g/l	Nga lindja e më tutje për përdorim në produktet e bazuara ne amino acide ose peptide për përdorim në pacientët të cilët kanë probleme me traktin gastro-intestinal, keq absorbimin e

			proteinave ose gabimet e lindura të metabolizmit
E 440	Pektinat	10 g/l	Nga lindja e më tutje në produktet e përdorura në rastin e çrregullimeve gastro-intestinale
E 466	Mono- dhe digliceride të acideve yndyrore	10 g/l ose kg	Nga lindja e më tutje në produktet për menaxhimin e dietave të çrregullimeve metabolike
E 471	Mono- dhe digliceride të acideve yndyrore	5 g/l	Nga lindja e më tutje në dietat e specializuara, veçanërisht të atyre që i mungojnë proteinat
E 1450	Sucinat octenil natrium amidon	20 g/l	Në formulat e fëmijëve të vegjël

UDHËZIM
Nr.20, datë 8.9.2011

PËR METODAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE TË LIGJIT NR.9917, DATË 19.5.2008 “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të nenit 28, pika 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit””, me propozim të autoritetit përgjegjës, Ministri i Financave

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë mënyrat dhe procedurat e raportimit, afatet kohore, standardet dhe kriteret që duhet të përdorin subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “k” të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, në funksion të zbatimit të këtij ligji.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 2 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

“Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë.

“Raporti i transaksionit të parasë fizike” (RTPF) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion në para fizike në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

“Raporti i transaksionit të vlerave” (RTV) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion jo në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

“Raporti i vetëkontrollit” është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe që plotësohet dhe raportohet nga subjektet me kërkesën e “autoritetit përgjegjës”, në lidhje me përmbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore.

Neni 3

Identifikimi dhe verifikimi i klientit dhe pronarit përfitues

1. Në zbatim të nenit 4 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, subjektet bëjnë identifikimin e klientëve (të vazhdueshëm apo rastësor) dhe verifikimin e identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopjeve të noterizuara:

a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:

- Letërnjoftim ID (kartë identiteti);
- Pasaportë brenda afatit të skadencës.

Për individë jorezidentë:

- Pasaportë, brenda afatit të skadencës;
- ID, kartë identiteti (vetëm për vendet e BE-së), brenda afatit të skadencës.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Statuti;
- Akti i themelimit;
- Ekstrakte të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- NUIS/NIPT.

Për shoqëri jorezidente:

- Dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin e rezidencës (vendim i gjykatës ose ekstrakt nga regjistri tregtar);

- Statuti i shoqërisë;
- Dokumenti i identifikimit të personave të autorizuar.

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Akti i themelimit të shoqërisë;
- Statuti i shoqërisë;
- Vendimi i gjykatës për regjistrimin si person juridik.

2. Dokumente të tjera shtesë që mund të kërkojnë nga subjekti, por pa u kufizuar vetëm në to, sipas nevojës për identifikimin dhe për verifikimin e identitetit të klientit, si dhe në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit janë:

a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:

- Certifikata të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile;
- Diploma shkollë/universitare;
- Leje drejtimi e automjetit;
- Leje hyrje apo qëndrimi për të huajt;
- Libreza apo kontratë pune;
- Kontrata e blerjes/qirasë së banesës;
- Kontrata me operatorë shërbimesh, si telefon fiks, celular, ujë, energji elektrike, etj;
- Vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoritetet vendore.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Leje/licencat e ushtrimit të aktivitetit;
- Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Leje/licencat të ushtrimit të aktivitetit;
- Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.

3. Identifikimi i klientëve bëhet gjithnjë nga subjektet dhe mbështetja te palët e tjera për kryerjen e këtij procesi nuk është e lejueshme.

4. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues. Në rastet kur klienti është person juridik, duhet kryer identifikimi dhe verifikimi për zotëruesit përfundimtarë të personit juridik duke kërkuar dokumente shtesë, të cilat provojnë identitetin dhe lidhjen e pronarit përfitues apo zotëruesit përfundimtar me personin juridik dhe me atë që kryen transaksionin.

5. Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator, nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionarëve të kompanisë. Për qëllime të këtij udhëzimi, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Neni 4

Vigjilenca e duhur ndaj klientit

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet:

1. Duhet të hartojnë e të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Duhet të marrin masa për të kuptuar strukturën e pronësisë e të kontrollit të klientëve, që janë persona juridikë dhe për të përcaktuar se cilët janë individët që kanë në pronësi apo kontrollojnë klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik.

3. Duhet të marrin miratimin e instancave më të larta të administrimit/drejtimit dhe të dokumentojnë respektivisht për çdo institucion përgjegjës të përkatëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, përpara se të vendosin marrëdhënie biznesi për shërbimet bankare korrespondente.

4. Që para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, duhet të përcaktojnë për të gjithë klientët nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi;

5. Duhet të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit me klientin.

6. Duhet të përcaktojnë procedurat dhe mjetet e menaxhimit të riskut për rastet kur klienti lejohet të vendosë dhe të përdorë marrëdhënien e biznesit para verifikimit të identitetit. Këto procedura duhet të përfshijnë një sërë masash, si kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen.

7. Në rastet kur subjekti ka filluar marrëdhënien e biznesit, sipas pikës 6 të këtij neni, dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve nga ana e klientit është i paafte të zbatojë detyrimin e vigjilencës së duhur, të përshkruar në këtë nen, duhet të përfundojë marrëdhënien e biznesit dhe të dërgojë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

8. Subjektet duhet të zbatojnë këto masa për vigjilencën e duhur edhe ndaj klientëve ekzistues, bazuar në të dhëna, fakte dhe nivelin e riskut të ekspozimit të tyre ndaj pastrimit të produkteve të veprave penale apo financimit të terrorizmit.

Neni 5

Vigjilenca e zgjeruar

Në funksion të zbatimit të vigjilencës së zgjeruar, subjektet e këtij udhëzimi:

1. Duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla. Të dhënat mbi konkluzionet e analizave duhet të mbahen për një periudhë pesëvjeçare dhe t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse/licencuese dhe auditorëve të brendshëm apo të jashtëm.

2. Subjektet e germës “a” të nenit 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar:

- duhet të marrin masat e duhura, në mënyrë që të sigurohen se bankat e huaja korrespondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë;

- nuk duhet të mbajnë marrëdhënie korrespondente me banka, llogaritë e të cilave përdoren nga bankat guaskë;

- Në rastet kur evidentojnë apo konstatojnë se llogaritë e bankës korrespondente përdoren nga bankat guaskë, ato duhet të ndërpresin menjëherë marrëdhënien e biznesit dhe t'i raportojnë autoritetit përgjegjës.

3. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për të përcaktuar, ndër të tjera, nëse një klient apo personat e lidhur me të janë persona të ekspozuar politikisht. Në këtë kontekst subjektet:

a) duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme, të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (Worldcheck, Factiva, etj), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj;

b) duhet të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues bëhet person i ekspozuar politikisht;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

4. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për organizata jofitimprurëse. Në këtë kontekst, subjektet:

a) duhet të kërkojnë dhe marrin të dhëna mbi natyrën e veprimtarisë, administrimit dhe drejtimit të tyre, si dhe burimin e fondeve;

b) duhet të hartojnë dhe zbatojnë procedurat e menaxhimit të riskut;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

5. Të përcaktojnë nëse klientët janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi.

6. Nëse subjektet nuk mund të zbatojnë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar:

a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksionet;

b) duhet të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek “autoriteti përgjegjës”.

Neni 6

Monitorimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve të biznesit

Subjektet duhet të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin. Ky monitorim duhet të përfshijë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij dhe profilin e riskut, si dhe burimin e fondeve.

Subjektet duhet të sigurohen nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur përditësohet dhe është koherent. Ky proces kërkohet të ndërmerret veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë.

Neni 7

Organizimi dhe përgjegjësitë e strukturës raportuese të subjektit

1. Subjektet raportuese të këtij udhëzimi duhet të krijojnë një strukturë për të parandaluar përdorimin e subjektit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

2. Subjektet duhet të emërojnë një person përgjegjës dhe një zëvendëspërgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, të cilët të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi.

3. Në rast se numri i punonjësve të subjekteve është më pak se tre persona, detyrimet e këtij neni përmbushen nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit dhe nuk kërkohet hartimi i një rregulloreje të veçantë.

4. Subjektet duhet t'i trajnojnë periodikisht punonjësit e tyre përmes një programi vjetor për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, përfshirë këtu edhe njohjen me ndryshimet ligjore në këtë fushë. Trajnimet e zhvilluara dokumentohen dhe u vihen në dispozicion përfaqësuesve të "autoritetit përgjegjës", kur një gjë e tillë kërkohet prej tyre.

Neni 8

Shërbimet e transferimit të parave ose të vlerave

1. Subjektet kërkojnë nga institucionet financiare nga ku dërgohen transfertat, të dhëna për dërguesin, të cilat merren përmes formularit që shoqëron transfertën, në të cilin duhet të përfshihen këto të dhëna:

- emri;
- mbiemri;
- vendbanimi dhe vendqëndrimi;
- numri i dokumentit të identifikimit;
- numri i llogarisë së dërguesit dhe në mungesë të tij numri unik i referencës;
- emri i institucionit financiar nga ku nisat transfertat;
- përshkrimi i dërgesës.

2. Nëse subjektet që kryejnë transfertat parash ose vlerash, për të cilat nuk arrijnë të sigurojnë informacionin bazë sipas pikës 1 të këtij neni, subjektet refuzojnë pranimin e transfertës dhe ia raportojnë këtë rast "Autoritetit përgjegjës" menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Neni 9

Raportimi i aktiviteteve të dyshimta tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin raport autoritetit përgjegjës, në të cilin parashtrajnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

2. Ky raportim kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementeve të dyshimta dhe të dhënave që subjektet kanë në dispozicion për ta arsyetuar atë, pavarësisht shumës së transaksioneve të kryera/ose që janë duke u kryer/ose që do të kryhen.

3. Formulari (RAD) duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet dyshimet e parashtruara në raport, si: nxjerrjen e llogarisë bankare, dokumentet e identifikimit, të dhënat e transfertave, kontratat, etj., dërgohet i plotë me shkresë zyrtare.

4. Në raste urgjente subjektet mund ta përcjellin informacionin për aktivitetin e dyshimtë paraprakisht me telefon tek autoriteti përgjegjës, të shoqëruar me shkresë zyrtare, sipas afatit të pikës 1 të këtij neni.

Neni 10

Raportimi i transaksioneve të vlerave tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet janë të detyruara të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda pesë ditëve pune nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, kryer si një transaksion i vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 72 orëve.

2. Në funksion të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, subjektet do të konsiderojnë si të kryera në para fizike çdo transaksion që nuk është i shoqëruar me një dokument justifikues bankar.

3. Subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, janë të detyruara të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda pesë ditëve pune nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 72 orëve.

Neni 11

Inspektimi dhe trajnimet

1. Autoriteti përgjegjës kontrollon, me anë të inspektimeve, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse, zbatimin e detyrimeve ligjore dhe vlerëson përmbushjen e tyre nga subjektet.

2. Autoritetet mbikëqyrëse/ licencuese, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës, hartojnë dhe zbatojnë programe informimi dhe trajnimi të subjekteve, lidhur me ndryshimet ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Mbi bazë të kërkesës së autoritetit përgjegjës, plotësohet dhe raportohet nga subjektet raporti i vetëkontrollit, në lidhje me përmbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore. Subjektet vënë në dispozicion të dhëna dhe dokumente të hartuara e miratuara prej tyre në funksion të vlerësimit nga autoriteti përgjegjës të përputhshmërisë së programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

Neni 12

Detyrimet e ruajtjes së të dhënave

Subjektet duhet të ruajnë dokumentacionin për identifikimin, llogaritë, si edhe korrespondencën me klientin për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë apo përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit. Me kërkesën e autoritetit përgjegjës, dokumentacioni ruhet nga subjektet për më shumë se 5 vjet.

Të dhënat e siguruar për klientët nga subjektet dhe masat e marra prej tyre në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dokumentohen, administrohen rregullisht dhe vihen në dispozicion të autoritetit përgjegjës mbi bazë të kërkesës së këtij të fundit, jo më vonë se 15 ditë kalendarike, apo si dokumente shtesë për arsyetimin e dyshimeve rast pas rasti.

Neni 13

Dispozita të fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi dhe anekseve dhe instruksioneve bashkëlidhur, si pjesë organike të tij:

- a) Aneksi I “Raporti për aktivitetin e dyshimtë” (RAD);
- b) Aneksi II “Raporti i transaksioneve të parasë fizike” (RTPF);
- c) Aneksi III “Raporti i transaksioneve të vlerave” (RTV);

d) Aneksi IV “Raporti i vetëkontrollit”, ngarkohen subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “k” të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet “autoriteti përgjegjës” - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

3. Ky udhëzim, së bashku me anekset I, II, III dhe IV, do të jenë të vetmet standarde të pranueshme për raportim tek “autoriteti përgjegjës”, të cilat mund të pësojnë ndryshime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr.12, datë 5.2.2009 “Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i Ministrisë të Financave, së bashku me anekset përkatëse, shfuqizohet.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

ANEKSI I
 RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni një prej kutive: <input type="checkbox"/> Pastrim parash; <input type="checkbox"/> Financim i terrorizmit;	
2. Zgjidhni një prej kutive: <input type="checkbox"/> Raport i ri; <input type="checkbox"/> Përmirëson një raport të mëparshëm;	
Pjesa I Informacion mbi aktivitetin e dyshimtë:	
Statusi ligjor i personit: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/>	
Përfaqësues ligjor: 1.a.Emri: _____ b. Atësia: _____ c. Mbiemri: _____	
ç. Emri i shoqërisë: _____	
2. Datëlindja/Data e regjistrimit:	3.Shtetësia: _____
4. Dokumenti i identifikimit: a <input type="checkbox"/> Leje drejtimi automjeti; b. <input type="checkbox"/> pasaportë; c. <input type="checkbox"/> certifikatë; d. <input type="checkbox"/> tjetër: _____;	
Numri i dokumentit: _____ Autoriteti: _____	
5. NUIS/NIPT: _____	
6. Adresa: _____	
7. Punësim/lloji i aktivitetit: _____	
Data e kryerjes së transaksionit _____	
Monedha: <input type="checkbox"/> LEK <input type="checkbox"/> EUR <input type="checkbox"/> USD <input type="checkbox"/> Tjetër _____;	
9. Shuma e transaksionit: _____;	
10. Numri i llogarisë/ve: a. _____; b. _____;	
Pjesa II Shpjegime/përshkrime të aktivitetit të dyshimtë:	
Pjesa III Informacion mbi subjektin raportues:	
Emri: _____;	Data e raportimit: _____;
Personi përgjegjës: _____;	Tel/e-mail: _____;
Firma: _____;	_____;
Aprovuesi: _____;	Adresa: _____;

INSTRUKSIONE
PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT “RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË” RAD

HYRJE

“Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek “autoriteti përgjegjës” për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjektet, për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash ose financim të terrorizmit.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse dërgohet te DPPPP-ja, një raport i ri apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I: INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË

Statusi ligjor i personit. Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë, sipas rastit, personit juridik, fizik, tregtar dhe përfaqësues ligjor.

Emri, atësia, mbiemri ose emri i shoqërisë. Shkruhen emri, atësia dhe mbiemri për individin dhe emri i shoqërisë për personat juridikë apo i subjektit për personat fizikë tregtarë.

Datëlindja/data e regjistrimit (dd/mm/vvvv). Nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zeroja (0) duhet t’i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03/04/1978.

Shtetësia. Shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

Dokumenti i identifikimit. Shkruhet lloji i dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

Numri i dokumentit dhe autoriteti. Këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, numri personal, si dhe autoriteti shtetëror që e ka lëshuar atë.

NIPT. Shkruhet numri i identifikimit të personit të tatueshëm për personat juridikë.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Punësim/lloji i aktivitetit. Jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Data e kryerjes së transaksionit. Data e transaksionit shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t’i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 05/05/2008.).

Monedha. Bëhet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit p.sh. Lek, USD, GBP, EUR etj.

Shuma e transaksionit. Shkruhet shuma në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhur me njëri-tjetrin.

Numri i llogarisë/ve. Shkruhen numri/at e llogarive të përfshira në aktivitetin e dyshimtë.

PJESA II: SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit dhe të arsyeve për dyshim.

PJESA III: INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit

në formatin (dd/mm/vvvv), si dhe numrin e telefonit/adresën e-mail të personit përgjegjës më anë të të cilit “Autoriteti përgjegjës” mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

ANEKSI II
RAPORTI I TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE (RTPF)
 (Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.5 milion lekë)

Zgjidhni kutinë e duhur:	
a. <input type="checkbox"/> Raportim i ri; b. <input type="checkbox"/> Përmirëson një raportim të mëparshëm;	
c. <input type="checkbox"/> Përfshihen më shumë se një individ/shoqëri ç. <input type="checkbox"/> Transaksione të lidhura	
PJESA I PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION	
SEKSIONI A –PERSONI QË KRYEN TRANSAKSIONIN	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____;	
ç. Emri i shoqërisë _____;	
2 Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit. _____ b. Numri _____;	
c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____;	
d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____;	
ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	
SEKSIONI B – PERSONI NË EMËR TË TË CILIT KRYHET TRANSAKSIONI	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i Shoqërisë _____;	
2 Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;	
3.a. Dokumenti i identifikimit _____; b. Numri _____;	
c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____;	
d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____;	
ë. NIPT _____; f. Adresa: _____;	
PJESA II PERSONI/AT PËRFITUES	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____;	
ç. Emri i shoqërisë _____;	
2 Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3.a. Dokumenti i identifikimit. _____ b. Numri _____;	
c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit. _____;	
d. Vendlindja. _____; e. Shtetësia. _____;	
ë. NIPT. _____; f. Adresa _____;	
VEPRIMI FINANCIAR I KRYER:	
1. Numri i llogarisë: _____;	3. Data e transaksionit: _____;
2. Shuma e transaksionit: _____;	4. Lloji i transaksionit: _____;
	5. Monedha: <input type="checkbox"/> LEK <input type="checkbox"/> EUR <input type="checkbox"/> USD <input type="checkbox"/> Tjetër _____;
PJESA III INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES	
Emri: _____;	Data e raportimit _____;
Personi përgjegjës: _____;	Tel/e-mail: _____;
Aprovuesi: _____;	Adresa: _____;
PJESA IV PLOTËSOHET NËSE NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË INDIVID/SHOQËRI	
SEKSIONI A – PERSONI QË KRYEN TRANSAKSIONIN	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____;	
ç. Emri i shoqërisë _____;	
2 Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit. _____ b. Numri _____;	
c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____;	
d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____;	
ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	

SEKSIONI B – PERSONI NË EMËR TË TË CILIT KRYHET TRANSAKSIONI

1. a. Emri _____ ; b. Atësia _____ ; c. Mbiemri _____ ; ç. Emri i shoqërisë _____ ;
2 Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;
3.a. Dokumenti i identifikimit. _____ b. Numri _____ ; c. Autoriteti _____ ; ç. Datëlindja/data e regjistrimit. _____ ; d. Vendlindja. _____ ; e. Shtetësia. _____ ; ë. NIPT. _____ ; f. Adresa _____ ;

INSTRUKSIONET**PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE**

(Për transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.5 milion lekë)

Formulari i raportimit të transaksioneve në para fizike (RTPF), është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Me anë të këtij formulari bëhet raportimi nga subjektet i transaksionit/eve në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.5 milion lekë (ose kundërvlera në një monedhë tjetër).

Bëni një kryq në kutinë/të sipas rastit të raportimit që bëhet (P.sh. raportim i ri, përmirësim i një raportimi të mëparshëm, nëse ka persona të shumëfishtë të përfshirë në transaksion ose bëhet fjalë për transaksione të lidhura të kryera brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim.).

PJESA I: PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION

Seksioni A: Plotësohet në të gjitha rastet

Nëse personi kryen një transaksion në emër të vet, plotësoni seksionin A dhe lëreni seksionin B, BOSH.

Nëse një individ kryen një transaksion në emër e tij dhe të personit/ave të tjerë, plotësoni seksionin A me të dhënat e mëposhtme për personin që kryen transaksionin dhe seksionin B për personin në emër të të cilit kryhet transaksioni.

Emri i personit/shoqërisë. Nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është një individ, shkruani në kutitë përkatëse emrin, mbiemrin, atësinë, në rast të kundërt shkruani emrin e shoqërisë.

Statusi ligjor i personit. Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë, sipas rastit, personit juridik, fizik, tregtar dhe përfaqësues ligjor.

Dokumenti i identifikimit. Shkruhet lloji i dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

Numri i dokumentit. Shkruhet numri i dokumentit të identifikimit.

Autoriteti. Shkruhet autoriteti shtetëror që e ka lëshuar.

Datëlindja/data e regjistrimit. Nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është një individ, shkruani datën e lindjes. Duhet të shkruhen tetë shifra për datën. Dy të parat tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet 03/04/1978.).

Vendlindja. Shkruhet vendlindja e personit në rastin e personit fizik.

Shtetësia. Shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin.

NIPT-i. Shkruhet numri i identifikimit të personit të tatueshëm për personat juridik.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e personit që kryen transaksionin.

SEKSIONI B: PERSONI NË EMËR TË TË CILIT KRYHET TRANSAKSIONI

Ky seksion plotësohet në të gjitha rastet kur personi/at që kryejnë transaksionin/et, janë të ndryshëm nga ata në emër të të cilëve kryhet transaksioni/et (P.sh. nëse një punonjës i EuroMax-it bën një depozitim për llogari të shoqërisë, kjo e fundit duhet të identifikohet në seksionin B dhe punonjësi që kryen transaksionin duhet të identifikohet në seksionin A.).

Subjektet duhet të plotësojnë të gjitha të dhënat sipas mënyrës së plotësimit të përshkruar më sipër në seksionin A.

PJESA II: PERSONI/AT PËRFITUES

Në këtë pjesë subjekti raportues jep të dhëna të plota për përfituesin në rastet kur ai është i ndryshëm nga personi në seksionin A dhe B.

Emri i personit/shoqërisë. Nëse personi/at përfitues i transaksioni/et është individ, shkruani në kutitë përkatëse emrin, mbiemrin, atësinë, në rast të kundërt shkruani emrin e shoqërisë.

Statusi ligjor i personit. Me anë të zgjedhjes së një prej kutive subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave përfitues sipas rastit personit juridik, fizik, tregtar dhe përfaqësues ligjor.

Dokumenti i identifikimit. Shkruhet lloji i dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit përfitues.

Numri i dokumentit. Shkruhet numri i dokumentit të identifikimit.

Autoriteti. Shkruhet autoriteti shtetëror që e ka lëshuar dokumentin.

Datëlindja/data e regjistrimit. Nëse personi përfitues i transaksionit është individ, shkruani datën e lindjes; në të kundërt shkruhet data e regjistrimit të personit juridik. Duhet të shkruhen tetë shifra për datën. Dy të parat tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet 03/04/1978.).

Vendlindja. Shkruhet vendlindja e personit në rastin e personit fizik.

Shtetësia. Shkruhet shtetësia e personit përfitues.

NIPT-i. Shkruhet numri i identifikimit të personit të tatueshëm për personat juridik.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e personit/ave përfitues.

VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

Numri i llogarisë. Shkruhet numri i llogarisë/ve të përfshira në kryerjen e transaksionit.

Shuma e transaksionit. Shkruhet shuma në para fizike në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhur me njëri-tjetrin, shuma e agreguar e të cilëve e kalon vlerën e 1.5 milionë lekë apo kundërvlerën në monedha të huaja.

Afati kohor për llogaritjen e transaksioneve të lidhura është 72 orë.

Data e transaksionit. Shkruhet data e kryerjes së transaksionit në formatin (ditë, muaj, vit) dd/mm/vvvv. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e transaksionit është 5 prill 2009, në raport duhet të shkruhet 05/04/2009.).

Për subjektet të cilat bëjnë dhe regjistrimin e orës së transaksionit shkruhet gjithashtu dhe ora.

Monedha. Bëhet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit (p.sh. Lek, USD, GBP, EUR etj.)

Lloji i transaksionit. Shënohet lloji i transaksionit (p.sh. këmbim valutor, depozitim, livrim kredie, transfertë etj.).

PJESA III: INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat e subjektit raportues, si: emri i plotë ligjor i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave.

Emri i personit që bën aprovimin e raportit (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd/mm/vvvv), numrin e telefonit/adresën e-mail të personit përgjegjës për t'i mundësuar "Autoritetit përgjegjës" dhënien e instruksioneve të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur, si dhe adresën e plotë të subjektit.

PJESA IV: PLOTËSOHET NË TË GJITHA RASTET KUR NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË INDIVID APO SHOQËRI.

ANEKSI III
RAPORTI I TRANSAKSIONEVE TË VLERAVE (RTV)
(Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 milionë lekë)

Zgjidhni kutinë e duhur:	
a. <input type="checkbox"/> Raportim i ri; b. <input type="checkbox"/> Përmirëson një raportim të mëparshëm; c. <input type="checkbox"/> Përfshihen më shumë se një individ/shoqëri; ç. <input type="checkbox"/> Transaksione të lidhura;	
PJESA I PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION	
SEKSIONI A – PERSONI QË KRYEN TRANSAKSIONIN	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i shoqërisë _____;	
2. Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit _____; b. Numri _____; c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____; d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	
SEKSIONI B – PERSONI NË EMËR TË TË CILIT KRYHET TRANSAKSIONI	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i shoqërisë _____;	
2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit _____; b. Numri _____; c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____; d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	
PJESA II PERSONI/AT PËRFITUES	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i shoqërisë _____;	
2. Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit _____; b. Numri _____; c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____; d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	
VEPRIMI FINANCIAR I KRYER	
1. Numri i llogarisë: _____;	3. Data e transaksionit: _____;
2. Shuma e transaksionit: _____;	4. Lloji i transaksionit: _____;
	5. Monedha: <input type="checkbox"/> LEK <input type="checkbox"/> EUR <input type="checkbox"/> USD <input type="checkbox"/> Tjetër _____;
PJESA III INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES	
Emri: _____;	Data e raportimit: _____;
Personi Përgjegjës: _____;	Tel/E-mail: _____;
Aprovuesi: _____;	Adresa: _____;
PJESA IV PLOTËSOHET NËSE NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË INDIVID/SHOQËRI	
SEKSIONI A – PERSONI QË KRYEN TRANSAKSIONIN	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i shoqërisë _____;	
2. Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit _____; b. Numri _____; c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____; d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	
SEKSIONI B – PERSONI NË EMËR TË TË CILIT KRYHET TRANSAKSIONI	
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i shoqërisë _____;	
2. Statusi ligjor: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
3. a. Dokumenti i identifikimit _____; b. Numri _____; c. Autoriteti _____; ç. Datëlindja/data e regjistrimit _____; d. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____; f. Adresa _____;	

INSTRUKSIONE

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT “RAPORTI I TRANSAKSIONEVE TË VLERAVE”
(Për transaksionet jo në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 milionë lekë)

HYRJE

Formulari i raportimit të transaksioneve të vlerave (RTV) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Me anë të këtij formulari bëhet raportimi nga subjektet i transaksionit/eve jo në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 milionë lekë (ose kundërvlera në një monedhë tjetër).

Bëni një kryq në kutinë/të sipas rastit të raportimit që bëhet (P.sh. raportim i ri, përmirësim i një raportimi të mëparshëm, nëse ka persona të shumëfishtë të përfshirë në transaksion ose bëhet fjalë për transaksione të lidhura të kryera brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim.).

PJESA I: PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION

Seksioni A: Plotësohet në të gjitha rastet

Nëse personi kryen një transaksion në emër të vet, plotësoni seksionin A dhe lëreni seksionin B, bosh.

Nëse një individ kryen një transaksion në emër të tij dhe të personit/ave të tjerë, plotësoni seksionin A me të dhënat e mëposhtme për personin që kryen transaksionin dhe seksionin B për personin në emër të të cilit kryhet transaksioni.

Emri i personit/shoqërisë. Nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është një individ, shkruani në kutitë përkatëse emrin, mbiemrin, atësinë, në rast të kundërt shkruani emrin e shoqërisë.

Statusi ligjor i personit. Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit personit juridik, fizik, tregtar dhe përfaqësues ligjor.

Dokumenti i identifikimit. Shkruhet lloji i dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

Numri i dokumentit. Shkruhet numri i dokumentit të identifikimit.

Autoriteti. Shkruhet autoriteti shtetëror që e ka lëshuar.

Datëlindja/data e regjistrimit: Nëse personi përfitues i transaksionit është një individ, shkruani datën e lindjes në të kundërt shkruhet data e regjistrimit të personit juridik. Duhet të shkruhen tetë shifra për datën (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet 03/04/1978.).

Vendlindja. Shkruhet vendlindja e personit në rastin e personit fizik.

Shtetësia. Shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin.

NIPT-i. Shkruhet numri i identifikimit të personit të tatueshëm për personat juridik.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e personit që kryen transaksionin.

SEKSIONI B: PERSONI NË EMËR TË TË CILIT KRYHET TRANSAKSIONI

Ky seksion plotësohet në të gjitha rastet kur personi/at që kryejnë transaksionin/et, janë të ndryshëm nga ata në emër të të cilëve kryhet transaksioni/et (P.sh. nëse një punonjës i EuroMax-it bën një depozitim për llogari të shoqërisë, kjo e fundit duhet të identifikohet në seksionin B dhe punonjësi që kryen transaksionin duhet të identifikohet në seksionin A.).

Subjektet duhet të plotësojnë të gjitha të dhënat sipas mënyrës së plotësimit të përshkruar më sipër në seksionin A.

PJESA II : PERSONI/AT PËRFITUES

Në këtë pjesë subjekti raportues jep të dhëna të plota për përfituesin në rastet kur ai është i ndryshëm nga personi në seksionin A dhe B.

Emri i personit/shoqërisë. Nëse personi/at përfitues i transaksioni/et është individ, shkruani në kutitë përkatëse emrin, mbiemrin, atësinë, në rast të kundërt shkruani emrin e shoqërisë.

Statusi ligjor i personit. Me anë të zgjedhjes së një prej kutive subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave përfitues sipas rastit personit juridik, fizik, tregtar dhe përfaqësues ligjor.

Dokumenti i identifikimit. Shkruhet lloji i dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit përfitues.

Numri i dokumentit. Shkruhet numri i dokumentit të identifikimit.

Autoriteti. Shkruhet autoriteti shtetëror që e ka lëshuar dokumentin.

Datëlindja/data e regjistrimit. Nëse personi përfitues i transaksionit është një individ, shkruani datën e lindjes në të kundërt shkruhet data e regjistrimit të personit juridik. Duhet të shkruhen tetë shifra për datën. Dy të parat tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes/regjistrimit. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet 03/04/1978.).

Vendlindja. Shkruhet vendlindja e personit në rastin e personit fizik.

Shtetësia. Shkruhet shtetësia e personit përfitues.

NIPT-i. Shkruhet numri i identifikimit të personit të tatueshëm për personat juridik.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e personit/ave përfitues.

VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

Numri i llogarisë. Shkruhet numri i llogarisë/ve të përfshira në kryerjen e transaksionit.

Shuma e transaksionit. Shkruhet shuma në para fizike në lek për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhur me njëri tjetrin, shuma e agreguar e të cilëve e kalon vlerën e 1.5 milion lekë apo kundërvlerën në monedha të huaja. Afati kohor për llogaritjen e transaksioneve të lidhura është 72 orë.

Data e transaksionit. Shkruhet data e kryerjes së transaksionit në formatin (ditë, muaj, vit) dd/mm/vvvv. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e transaksionit është 5 prill 2009, në raport duhet të shkruhet 05/04/2009.).

Për subjektet të cilat bëjnë dhe regjistrimin e orës së transaksionit, shkruhet gjithashtu dhe ora.

Monedha. Bëhet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit p.sh. Lek, USD,GBP,EUR etj.

Lloji i transaksionit. Shënohet lloji i transaksionit, (p.sh. këmbim valutor, depozitim, livrim kredie, transfertë etj.).

PJESA III: INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat e subjektit raportues, si: emri i plotë ligjor i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, emri i personit që bën aprovimin e raportit (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd/mm/vvvv), numrin e telefonit/adresën e-mail të personit përgjegjës për t'i mundësuar "Autoritetit përgjegjës" dhënien e instruksioneve të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur, si dhe adresën e plotë të subjektit.

PJESA IV: PLOTËSOHET NË TË GJITHA RASTET KUR NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË INDIVID APO SHOQËRI.

**ANEKSI IV
RAPORT I VETËKONTROLLIT**

EMRI I SUBJEKTIT RAPORTUES: _____		
ADRESA: _____		
KATEGORIA E SUBJEKTIT:		
EMRI I PERSONIT PËRGJEGJËS:		
Tel:	Fax:	E-mail:
Masat e marra nga subjekti për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit.....		
Trajnimet e personelit:		
Përshkrimi i aktivitetit të subjektit:		
Raportime të bëra nga subjekti: RTPF:..... RTV:..... RAD:.....		
EMRI I PERSONIT PËRGJEGJËS: _____ FIRMA: _____	DATA: __/__/____;	

INSTRUKSIONE PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT TË VETËKONTROLLIT

HYRJE

“Raporti i vetëkontrollit” është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe plotësohet nga subjektet me kërkesën e “Autoritetit përgjegjës” me të dhënat mbi masat e marra për zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Formulari i plotësuar dhe dokumentacioni bashkëngjitur i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave brenda afateve kohore të përcaktuara në kërkesë.

Emri i subjektit raportues. Shkruhet emri i plotë i subjektit raportues.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e subjektit raportues.

Kategoria e subjektit. Në këtë pjesë të raportit shkruhet kategoria së cilës i përket subjekti në bazë të nenit 3 të ligjit nr.9917.

Emri i personit përgjegjës. Shkruhet emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në subjektin raportues, numri i telefonit/faksit dhe adresa elektronike e tij. Për subjektet që kanë më shumë se tre punonjës në rreshtin e mëposhtëm shkruhet dhe emri i personit tjetër përgjegjës.

Masat e marra nga subjekti për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Subjekti raportues bën një paraqitje të masave parandaluese të marra prej tij bazuar në nenin 11 të ligjit nr.9917).

Trajnimet e personelit. Subjekti mund të përshkruajë trajnimet e kryera për personelin, si dhe nëse ka paraqitur ndonjë kërkesë për trajnim dhe asistencë nga DPPP-jë.

Përshkrimi i aktivitetit të subjektit. Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit në lidhje me procedurat e tij “Njihe klientin tënd”, “Vigjilencën e Zgjeruar”, si dhe të bashkëngjisë udhëzime ose rregullore të brendshme që disponon për këtë qëllim.

Raportimet e bëra nga subjekti. Shkruhen të dhënat e subjektit për raportet e dërguara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parasë (p.sh. numri i raporteve RTPF, RTV dhe RAD).

Emri i personit përgjegjës. Shënohet emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave.

Firma. Raporti firmoset nga ana e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave përpara se të dërgohet tek “Autoriteti përgjegjës”.

Data. Subjekti shënon datën e dërgimit të raportit tek “Autoriteti përgjegjës” e cila duhet të shkruhet në tetë shifra. Dy të parat tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zeroja (0) duhet t’i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet 03/04/1978.).

UDHËZIM
Nr.21, datë 8.9.2011

PËR MËNYRAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË PROFESIONEVE TË LIRA
JOFINANCIARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 28 pika 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Neni 1
Rregulla të përgjithshme

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë mënyrat dhe procedurat e raportimit, afatet kohore, standardet dhe kriteret që duhet të përdorin subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i” të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, në funksion të zbatimit të këtij ligji.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 2 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

“Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë.

“Raporti i transaksionit të parasë fizike” (RTPF) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion në para fizike në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

“Raporti i vetëkontrollit” është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe që plotësohet dhe raportohet nga subjektet me kërkesën e “Autoritetit përgjegjës”, në lidhje me përbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore.

Neni 3
Identifikimi i klientit

Në zbatim të nenit 4 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, subjektet bëjnë identifikimin e klientëve (të përherëshëm apo rastësor) dhe verifikimin e identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuara:

- a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:
 - Letërnyoftim ID (kartë identiteti);
 - Pasaportë.

Për individë jorezidentë:

- Pasaportë, brenda afatit të skadencës;
- ID, kartë identiteti (vetëm për vendet e BE-së), brenda afatit të skadencës.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Statuti;
- Akti i themelimit;
- Ekstrakt të lëshuar nga QKR-ja;
- NUIS/NIPT.

Për shoqëri jorezidente:

- Dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin e rezidencës (vendim i gjykatës ose ekstrakt nga regjistri tregtar);

- Statuti i shoqërisë;
- Dokumenti i identifikimit të personave të autorizuar.

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Akti i themelimit të shoqërisë;
- Statuti i shoqërisë;
- Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik.

2. Dokumente të tjera shtesë që mund të kërkohen nga subjekti, por pa u kufizuar vetëm në to, sipas nevojës për identifikimin dhe për verifikimin e identitetit të klientit, si dhe në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit janë:

a) Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:

- Certifikata të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile;
- Diploma shkollore/universitare;
- Leje drejtimi e automjetit;
- Leje hyrjeje apo qëndrimi për të huajt;
- Libreza apo kontratë pune;
- Kontrata e blerjes/qirasë së banesës;
- Kontrata me operatorë shërbimesh, si telefon fiks, mobile, ujë, energji elektrike etj.;
- Vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoritetet vendore.

b) Për personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Leje/licencat e ushtrimit të aktivitetit;
- Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Leje/licencat e ushtrimit të aktivitetit;
- Kontrata e blerjes/qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit.

3. Identifikimi i klientëve bëhet gjithnjë nga subjektet dhe mbështetja te palët e tjera për kryerjen e këtij procesi nuk është e pranueshme.

4. Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues. Në rastet kur klienti është person juridik, duhet kryer identifikimi dhe verifikimi për zotëruesit përfundimtar të personit juridik duke kërkuar dokumente shtesë të cilat provojnë identitetin dhe lidhjen e pronarit përfitues apo zotëruesit përfundimtar me personin juridik dhe me atë që kryen transaksionin.

5. Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator, nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionarëve të kompanisë. Për qëllime të këtij udhëzimi, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Neni 4 **Vigjilenca e duhur ndaj klientit**

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet:

1. Duhet të hartojnë e të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Duhet të marrin masa për të kuptuar strukturën e pronësisë e të kontrollit të klientëve, që janë persona juridikë dhe për të përcaktuar se cilët janë individët që kanë në pronësi apo kontrollojnë klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik.

3. Duhet që para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënie të përcaktojnë për të gjithë klientët nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi.

4. Duhet të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit.

Subjektet duhet të zbatojnë këto masa për vigjilencën e duhur edhe ndaj klientëve ekzistues, bazuar në të dhëna, fakte dhe nivelin e riskut të ekspozimit të tyre ndaj pastrimit të produkteve të veprave penale apo financimit të terrorizmit.

Neni 5 **Vigjilenca e zgjeruar**

Në funksion të zbatimit të vigjilencës së zgjeruar, subjektet e këtij udhëzimi:

1. Duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla. Të dhënat mbi konkluzionet e analizave duhet të mbahen për një periudhë pesëvjeçare dhe t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës.

2. Duhet të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për të përcaktuar ndër të tjera, nëse një klient apo personat e lidhur me të janë persona të ekspozuar politikisht. Në këtë kontekst subjektet:

a) duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme, të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (Worldcheck, Factiva etj.), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj;

b) duhet të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues bëhet person i ekspozuar politikisht;

c) duhet kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

3. Duhet të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për organizata jofitimprurëse. Në këtë kontekst subjektet:

a) duhet të kërkojnë dhe të marrin të dhëna mbi natyrën e veprimtarisë, administrimit dhe drejtimit të tyre, si dhe burimin e fondeve;

b) duhet të hartojnë dhe të zbatojnë procedurat e menaxhimit të riskut;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

4. Duhet të përcaktojnë nëse klientët janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi.

Neni 6

Monitorimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve të biznesit

Subjektet janë të detyruara, sipas rrethanave të caktuara, të kryejnë monitorime të vazhdueshme të marrëdhënies së biznesit me klientët e tyre, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë e subjektit për klientin, objektin e veprimtarisë dhe kategorizimin e tij, sipas shkallës së rrezikut që paraqet, duke përfshirë këtu përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave për klientin, si dhe menjëherë kur kanë arsye për të dyshuar se kushtet dhe gjendja faktike e klientit kanë ndryshuar.

Neni 7

Organizimi dhe përgjegjësitë e strukturës raportuese të subjektit

1. Subjektet raportuese të këtij udhëzimi duhet të krijojnë një strukturë për të parandaluar përdorimin e subjektit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

2. Subjektet duhet të emërojnë një person përgjegjës dhe një zëvendëspërgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, të cilët të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi.

3. Në rast se numri i punonjësve të subjekteve është më pak se tre persona, detyrimet e këtij neni përmbushen nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit dhe nuk kërkohet hartimi i një rregulloreje të veçantë.

4. Subjektet duhet t'i trajnojnë periodikisht punonjësit e tyre përmes një programi vjetor për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, përfshirë këtu edhe njohjen me ndryshimet ligjore në këtë fushë. Trajnimet e zhvilluara dokumentohen dhe u vihen në dispozicion përfaqësuesve të "Autoritetit përgjegjës", kur një gjë e tillë kërkohet prej tyre.

Neni 8

Raportimi i aktiviteteve të dyshimta tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin raport autoritetit përgjegjës, në të cilin parashetrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

2. Ky raportim kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementëve të dyshimtë dhe të dhënave që subjektet kanë në dispozicion për ta arsyetuar atë, pavarësisht shumës së transaksioneve të kryera/ose që janë duke u kryer/ose që do të kryhen.

3. Formulari (RAD) duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet dyshimet e parashtruara në raport, si: nxjerrjen e llogarive bankare, dokumentet e identifikimit, të dhënat e transfertave, kontratat etj., dërgohet i plotë me shkresë zyrtare.

4. Në raste urgjente, subjektet mund ta përcjellin informacionin për aktivitetin e dyshimtë paraprakisht me telefon tek autoriteti përgjegjës, të shoqëruar me shkresë zyrtare, sipas afatit të pikës 1 të këtij neni.

Neni 9

Raportimi i transaksioneve të vlerave tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet janë të detyruara të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda pesë ditëve pune nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, kryer si një transaksion i vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, brenda 72 orëve.

2. Në funksion të zbatimit të këtij detyrimi për raportim, subjektet do të konsiderojnë si të kryer me para fizike çdo transaksion që nuk është i shoqëruar me një dokument justifikues bankar.

Neni 10

Inspektimi dhe trajnimet

1. Autoriteti përgjegjës kontrollon, me anë të inspektimeve, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse, zbatimin e detyrimeve ligjore dhe vlerëson përmbushjen e tyre nga subjektet.

2. Autoritetet mbikëqyrëse/licencuese vetëm ose në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës hartojnë dhe zbatojnë programe informimi dhe trajnimi të subjekteve, lidhur me ndryshimet ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Mbi bazë të kërkesës së autoritetit përgjegjës, plotësohet dhe raportohet nga subjektet raporti i vetëkontrollit, në lidhje me përmbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore. Subjektet vënë në dispozicion të dhëna dhe dokumente të hartuara e të miratuara prej tyre në funksion të vlerësimit nga autoriteti përgjegjës të përputhshmërisë së programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

Neni 11

Detyrimet e ruajtjes së të dhënave

Të dhënat e siguruar për klientët nga subjektet dhe masat e marra prej tyre në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dokumentohen dhe ruhen për 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit. Me kërkesën e autoritetit përgjegjës, dokumentacioni ruhet nga subjektet për më shumë se 5 vjet.

Këto të dhëna vihen në dispozicion të autoritetit përgjegjës mbi bazë të kërkesës së këtij të fundit, jo më vonë se 15 ditë kalendarike.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi dhe anekseve bashkëlidhur, si pjesë organike e tij:

- a) Aneksi I “Raporti për aktivitetin e dyshimtë” (RAD);
- b) Aneksi II “Raporti i transaksioneve të parasë fizike” (RTPF);
- c) Aneksi III “Raporti i vetëkontrollit”,

ngarkohen subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i” të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet “Autoriteti përgjegjës” - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

3. Ky udhëzim, së bashku me anekset I, II, III dhe IV, do të jenë të vetmet standarde të pranueshme për raportim tek “Autoriteti përgjegjës”, të cilat mund të pësojnë ndryshime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr.11, datë 5.2.2009 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare”, i Ministrisë të Financave, së bashku me anekset përkatëse, shfuqizohet.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE

Ridvan Bode

ANEKSI I
RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni një prej kutive: <input type="checkbox"/> Pastrim parash; <input type="checkbox"/> Financim i terrorizmit;	
2. Zgjidhni një prej kutive: <input type="checkbox"/> Raport i ri; <input type="checkbox"/> Përmirëson një raport të mëparshëm;	
Pjesa I Informacion mbi aktivitetin e dyshimtë: Statusi ligjor i personit: a. <input type="checkbox"/> Individ; b. <input type="checkbox"/> Person fizik tregtar; c. <input type="checkbox"/> Person juridik; d. <input type="checkbox"/> Përfaqësues ligjor;	
1.a. Emri: _____ b. Atësia: _____ c. Mbiemri: _____ ç. Emri i shoqërisë: _____	
2. Datëlindja/data e regjistrimit: . . . 3. Shtetësia: _____	
4. Dokumenti i identifikimit: a. <input type="checkbox"/> Leje drejtimi automjeti; b. <input type="checkbox"/> pasaportë; c. <input type="checkbox"/> certifikatë; d. <input type="checkbox"/> tjetër: _____;	
Numri i dokumentit: _____ Autoriteti: _____	
5. NUIS/NIPT: _____	
6. Adresa: _____	
7. Punësim/lloji i aktivitetit: _____	
Data e kryerjes së transaksionit _____;	
Monedha : <input type="checkbox"/> LEK <input type="checkbox"/> EUR <input type="checkbox"/> USD <input type="checkbox"/> Tjetër _____;	
9. Shuma e transaksionit: _____;	
10. Numri i llogarisë/ve: a. _____; b. _____;	
Pjesa II Shpjegime/përshkrime të aktivitetit të dyshimtë:	
Pjesa III Informacion mbi subjektin raportues:	
Emri: _____;	Data e raportimit: ____ . ____ . ____;
Personi përgjegjës: _____;	Tel/E-mail: _____;
Firma: _____;	_____;
Aprovuesi: _____;	Adresa: _____;

INSTRUKSIONE

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT “RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË” RAD

HYRJE

“Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të së cilit subjektet raportojnë tek “Autoriteti përgjegjës” për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjektet, për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash ose financim të terrorizmit.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse dërgohet te DPPP-të, një raport i ri apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I: INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË

Statusi ligjor i personit. Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit personit juridik, fizik, tregtar dhe përfaqësues ligjor.

Emri, atësia, mbiemri ose emri i shoqërisë. Shkruhen emri, atësia dhe mbiemri për individin dhe emri i shoqërisë për personat juridikë apo i subjektit për personat fizikë tregtarë.

Datëlindja/data e regjistrimit (dd/mm/vvvv). Nëse personi në emër të së cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03/04/1978.).

Shtetësia. Shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

Dokumenti i identifikimit. Shkruhet lloji i dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

Numri i dokumentit dhe autoriteti. Këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, numri personal, si dhe autoriteti shtetëror që e ka lëshuar atë.

NIPT-i. Shkruhet numri i identifikimit të personit të tatueshëm për personat juridik.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Punësim/lloji i aktivitetit. Jepet përshkrimi i punësimit ose i llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Data e kryerjes së transaksionit. Data e transaksionit shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 05/05/2008.).

Monedha. Bëhet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit p.sh.: Lek, USD, GBP, EUR etj.

Shuma e transaksionit. Shkruhet shuma në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

Numri i llogarisë/ve. Shkruhen numri/at e llogarive të përfshira në aktivitetin e dyshimtë.

PJESA II: SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit dhe të arsyeve për dyshim.

PJESA III: INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, Emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd/mm/vvvv), si dhe numri i telefonit/adresa e-mail e personit përgjegjës me anë të të

cilit "Autoriteti përgjegjës" mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

ANEKSI II
RAPORTI I TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE (RTPF)
 (Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.5 milion lekë)

Zgjidhni kutinë e duhur:			
a.	Raportim i ri	Përmirëson një raportim të mëparshëm	Përfshihen më shumë se një individ/shoqëri
b.		c.	ç.
			Transaksione të lidhura
PJESA I - PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION			
SEKSIONI A - <input style="width: 150px;" type="text"/>			
Personi që kryen transaksionin			
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____;			
ç. Emri i shoqërisë _____;			
2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;			
3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____;			
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____;			
dh. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____;			
ë. NIPT _____; f. Adresa _____;			
Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni			
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____;			
ç. Emri i shoqërisë _____;			
2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;			
3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____;			
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____;			
dh. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____;			
ë. NIPT _____; f. Adresa _____;			
SEKSIONI B - <input style="width: 150px;" type="text"/>			
Personi që kryen transaksionin			
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____;			
ç. Emri i shoqërisë _____;			
2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;			
3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____;			
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____;			
dh. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____;			
f. Adresa _____;			
Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni			
1. a. Emri _____; b. Atësia _____; c. Mbiemri _____; ç. Emri i shoqërisë _____;			
2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;			
3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____; c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____;			
dh. Vendlindja _____; e. Shtetësia _____; ë. NIPT _____;			
f. Adresa _____;			
PJESA II - INFORMACION MBI TRANSAKSIONIN/ET			
1. Nr. Rep. _____		2. Nr. Kol. _____	
3. Objekti _____; 4. Shuma e transaksionit: _____;		5. Data e transaksionit _____;	
7. Monedha: LEK EUR USD GBP CHF Tjetër _____;		6. Lloji i transaksionit: _____;	
9. Burimi i deklaruar _____;		8. Mënyra e pagesës _____;	
		10. Tjetër _____;	
PJESA III - INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES			
Emri: _____;		Data e raportimit: _____;	
Personi Përgjegjës: _____;		Tel/Email: _____;	
Aprovuesi _____;		Adresa: _____;	

PJESA IV PLOTËSOHET NËSE NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË INDIVID/SHOQËRI

PJESA I - Personat e përfshirë në transaksion

SEKSIONI A -

Personi që kryen transaksionin

1. a. Emri _____ ; b. Atësia _____ ; c. Mbiemri _____ ;
ç. Emri i shoqërisë _____ ;

2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar ; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;

3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____ ;
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____ ; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____ ;
dh. Vendlindja _____ ; e. Shtetësia _____ ;
ë. NIPT. _____ ; f. Adresa _____ ;

Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni

1. a. Emri _____ ; b. Atësia _____ ; c. Mbiemri _____ ;
ç. Emri i shoqërisë _____ ;

2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;

3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____ ;
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____ ; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____ ;
dh. Vendlindja _____ ; e. Shtetësia _____ ;
ë. NIPT _____ ; f. Adresa _____ ;

SEKSIONI B -

Personi që kryen transaksionin

1. a. Emri _____ ; b. Atësia _____ ; c. Mbiemri _____ ;
ç. Emri i shoqërisë _____ ;

2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar ; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;

3.a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____ ;
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____ ; d. Datëlindja/Data e regjistrimit _____ ;
dh. Vendlindja _____ ; e. Shtetësia _____ ;
ë. NIPT _____ ; f. Adresa _____ ;

Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni

1. a. Emri _____ ; b. Atësia _____ ; c. Mbiemri _____ ;
ç. Emri i shoqërisë _____ ;

2. Statusi ligjor: a. Individ; b. Person fizik tregtar; c. Person juridik; d. Përfaqësues ligjor;

3. a. Dokumenti i identifikimit _____ b. Numri i dokumentit _____ ;
c. Numri personal _____ ç. Autoriteti _____ ; d. Datëlindja/data e regjistrimit _____ ;
dh. Vendlindja _____ ; e. Shtetësia _____ ;
ë. NIPT _____ ; f. Adresa _____ ;

INSTRUKSIONET

PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE

(Për transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.5 milion lekë)

Formulari i “Raporti i transaksionit të parasë fizike” (RTPF) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion në para fizike në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njera-tjetrën.

Bëni një kryq në kutinë/të sipas rastit të raportimit që bëhet p.sh. raportim i ri; përmirësim i një raportimi të mëparshëm; nëse ka persona të shumëfishtë të përfshirë në transaksion ose bëhet fjalë për transaksione të lidhura.

PJESA I: PALËT E PËRFSHIRA NË TRANSAKSION

Pjesa 1: Personat e përfshirë ne transaksion

Seksioni A. Pala-përshkruani palën e parë të transaksionit (p.sh. pala shitëse, pala huadhënëse, pala sipërmarrëse etj.).

Personi që kryen transaksionin:

1. Jepen të dhënat e individit/subjektit, i cili është duke e kryer transaksionin, duke u plotësuar: emri, atësia, mbiemri, emri i shoqërisë.

2. Statusi ligjor: individ; person fizik; person juridik; përfaqësues ligjor.

- kur është individ: bëni një kryq te kuadrati individ dhe të plotësohen fushat-emër, atësia, mbiemri, punësimi/institucioni, profesioni, numri i dokumentit të identifikimit, numri personal, lloji i dokumentit, datëlindja, vendlindja dhe adresa;

- kur është person fizik apo shoqëri: bëni një kryq te kuadrati përkatës për personin fizik tregtar dhe personin juridik dhe të plotësohen rubrikat-emërtimi i shoqërisë, data e regjistrimit/themelimit, NIPT-i, adresa;

- kur është përfaqësues ligjor: bëni një kryq te kuadrati përkatës për “përfaqësuesin ligjor” dhe të plotësohen të gjitha fushat që përmban seksioni A.

Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni:

1. Jepen të dhënat e individit/subjektit, në emër të të cilit kryhen transaksionet, në rastet kur ky i fundit përfaqësohet nga një person i autorizuar prej tij, duke u plotësuar: emri, atësia, mbiemri, emri i shoqërisë.

2. Statusi ligjor: individ; person fizik; person juridik; përfaqësues ligjor.

- kur është individ: bëni një kryq te kuadrati individ dhe të plotësohen fushat-emër, atësia, mbiemri, punësimi/institucioni, profesioni, numri i dokumentit të identifikimit, lloji i dokumentit, datëlindja, vendlindja dhe adresa;

- kur është person fizik apo shoqëri: bëni një kryq te kuadrati përkatës për personin fizik tregtar dhe personin juridik dhe të plotësohen rubrikat-emërtimi i shoqërisë, data e regjistrimit/themelimit, NIPT-i, adresa;

- kur është përfaqësues ligjor: bëni një kryq te kuadrati përkatës për “përfaqësuesin ligjor” dhe të plotësohen të gjitha fushat që përmban seksioni A.

Seksioni B. Pala-përshkruani në kuadratin bosh palën e dytë të transaksionit (p.sh. pala blerëse, pala huamarrëse, pala porositëse etj.) dhe sipas rastit, plotësoni:

1. Jepen të dhënat e individit/subjektit i cili është duke e kryer transaksionin, duke u plotësuar: emri, atësia, mbiemri, emri i shoqërisë.

2. Statusi ligjor: individ; person fizik; person juridik; përfaqësues ligjor.

- kur është individ: bëni një kryq te kuadrati individ dhe të plotësohen fushat-emër, atësia, mbiemri, punësimi/institucioni, profesioni, numri i dokumentit të identifikimit, numri personal, lloji i dokumentit, datëlindja, vendlindja dhe adresa;

- kur është person fizik apo shoqëri: bëni një kryq te kuadrati përkatës për personin fizik tregtar dhe personin juridik dhe të plotësohen rubrikat-emërtimi i shoqërisë, data e regjistrimit/themelimit, NIPT-i, adresa;

- kur është përfaqësues ligjor: bëni një kryq te kuadrati përkatës për “përfaqësuesin ligjor” dhe të plotësohen të gjitha fushat që përmban seksioni A.

Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni:

1. Jepen të dhënat e individit/subjektit në emër të të cilit kryhen transaksionet, në rastet kur ky i fundit përfaqësohet nga një person i autorizuar prej tij, duke u plotësuar: emri, atësia, mbiemri, emri i shoqërisë.

2. Statusi ligjor: individ; person fizik; person juridik; përfaqësues ligjor.

- kur është individ: bëni një kryq te kuadrati individ dhe të plotësohen fushat-emër, atësia, mbiemri, punësimi/institucioni, profesioni, numri i dokumentit të identifikimit, lloji i dokumentit, datëlindja, vendlindja dhe adresa;

- kur është person fizik apo shoqëri: bëni një kryq te kuadrati përkatës për personin fizik tregtar dhe personin juridik dhe të plotësohen rubrikat-emërtimi i shoqërisë, data e regjistrimit/themelimit, NIPT-i, adresa;

- kur është përfaqësues ligjor: bëni një kryq te kuadrati përkatës për “përfaqësuesin ligjor” dhe të plotësohen të gjitha fushat që përmban seksioni A.

Në rastet kur kemi transaksione ku përfshihen më shumë se një palë e parë (shitës, huadhënës) apo palë e dytë (blerës, huamarrës) subjekti duhet të plotësojë faqen e dytë të këtij formulari, sipas seksioneve përkatëse “A” dhe “B” për secilën nga palët e përfshira në transaksion.

PJESA II: INFORMACION MBI TRANSAKSIONIN

Në këtë rubrikë të plotësohen të dhënat që subjekti disponon në lidhje me transaksionin.

Numri i repertorit dhe koleksionit. Ky informacion plotësohet vetëm nga noterët.

Data e regjistrimit. Shkruhet data e regjistrimit të kontratës (transaksionit).

Objekti. Përshkruhet objekti i këtij transaksioni, në rastin e noterëve, sipas përcaktimit të kontratës përkatëse. Por edhe në çdo rast tjetër objekti përkatës në këtë transaksion.

Lloji i kontratës. Përshkruhet lloji i transaksionit/kontratës si p.sh. kontratë shitblerje, huadhënie, sipërmarrje etj.

Shuma. Shkruhet shuma në para fizike në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën shuma e të cilave e kalon limitin e raportimit të përcaktuar nga ligji. Afati kohor për raportim të transaksionit/transaksioneve të lidhura është 72 orë.

Monedha. Të shkruhet monedha e transaksionit.

Mënyra e pagesës. Subjekti evidenton mënyrën se si është bërë pagesa, duke specifikuar në të edhe grafikun e pagesave.

Burimi i deklaruar i fondeve. Plotësohet nga subjekti raportues burimi i deklaruar nga palët i fondeve për kryerjen e transaksionit.

Informacioni shtesë. Kjo pjesë e raportit plotësohet atëherë kur subjekti raportues disponon të dhëna shtesë në lidhje me transaksionin.

Në rastet kur kemi transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, subjekti raportues do të shënojë shumën totale të pjesa e II e formularit, fusha shuma dhe në fushën informacioni shtesë do të renditen të gjitha transaksionet.

PJESA III: INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë plotësohen të dhëna rreth subjektit raportues si; emri, mbiemri dhe atësia për personat fizikë (ose emri i plotë ligjor i shoqërisë për personat juridik) emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave (për subjektet që kanë më shumë se tre nëpunës), data e raportimit në formatin (dd/mm/vvvv), numri i telefonit/adresa elektronike e personit përgjegjës, me anë të të cilit “Autoriteti përgjegjës” mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur, si dhe adresën e plotë të subjektit. Subjekti raportues shënon numrin e tij të identifikimit si personi i tatueshëm.

**ANEKSI III
RAPORT I VETËKONTROLLIT**

EMRI I SUBJEKTIT RAPORTUES: _____		
ADRESA: _____		
KATEGORIA E SUBJEKTIT:		
EMRI I PERSONIT PËRGJEGJËS:		
Tel:	Fax:	E-mail:
Masat e marra nga subjekti për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit		
Trajnimet e personelit:		
Përshkrimi i aktivitetit të subjektit:		
Raportime të bëra nga subjekti: RTPF:..... RAD:.....		
EMRI I PERSONIT PËRGJEGJËS: _____ FIRMA: _____	DATA: __ / __ / ____;	

INSTRUKSIONE PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT TË VETËKONTROLLIT

HYRJE

Formulari “Raporti i vetëkontrollit”, plotësohet nga subjektet me kërkesën e “Autoritetit përgjegjës” dhe përmban të dhënat mbi masat e marra për zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Formulari i plotësuar dhe dokumentacioni bashkëngjitur i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave brenda afateve kohore të përcaktuara në kërkesë.

Emri i subjektit raportues. Shkruhet emri i plotë i subjektit raportues.

Adresa. Shkruhet adresa e plotë e subjektit raportues.

Kategoria e subjektit. Në këtë pjesë të raportit shkruhet kategoria së cilës i përket subjekti në bazë të nenit 3 të ligjit nr.9917.

Emri i personit përgjegjës. Shkruhet emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në subjektin raportues, numri i telefonit/faksit dhe adresa elektronike e tij. Për subjektet që kanë më shumë se tre punonjës në rreshtin e mëposhtëm, shkruhet dhe emri i personit tjetër përgjegjës.

Masat e marra nga subjekti për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Subjekti raportues bën një paraqitje të masave parandaluese të marra prej tij bazuar në nenin 11 të ligjit nr.9917).

Trajnimet e personelit. Subjekti mund të përshkruajë trajnimet e kryera për personelin, si dhe nëse ka paraqitur ndonjë kërkesë për trajnim dhe asistencë ndaj DPPP-së.

Përshkrimi i aktivitetit të subjektit. Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit në lidhje me procedurat e tij “Njihe klientin tënd”, “Vigjilencën e zgjeruar”, si dhe të bashkëngjisë udhëzime ose rregullore të brendshme që disponon për këtë qëllim.

Raportimet e bëra nga subjekti. Shkruhen të dhënat e subjektit për raportet e dërguara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parasë (p.sh. numri i raporteve RTPF, RTV dhe RAD).

Emri i personit përgjegjës. Shënohet emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave.

Firma. Raporti firmoset nga ana e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave përpara se të dërgohet tek “Autoriteti përgjegjës”.

Data. Subjekti shënon datën e dërgimit të raportit tek “Autoriteti përgjegjës” e cila duhet të shkruhet në tetë shifra. Dy të parat tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zeroja (0) duhet t’i paraprijë çdo shifre teke (P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet 03/04/1978.).

VENDIM
(I shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 23.6.2011, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Halil Halili, i datëlindjes 27.6.1990 dhe caktimin si kujdestare të tij kërkuesen, Zoje Halili, e datëlindjes 18.12.1967.

KËRKESË

Shtetasja Majlinda Duka, e bija e Mehmetit dhe e Naxhijes, e datëlindjes 27.9.1975, lindur dhe banuese Durrës, në adresën: rruga "Vath Truja", lagjja nr.14, Nish-Tulla, Durrës, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Kostandin Jovan Duka.

KËRKUESJA
Majlinda Duka

KËRKESË

Shtetasja Sanije Shehu (Dema), e bija e Demirit dhe e Nexhmijes, e datëlindjes 10.6.1942, lindur në fashtin Homesh, Shupenzë, me banim në Qendër Tomin, Peshkopi, kërkon shpalljen të vdekur të xhaxhait të saj, shtetasit Hamdi Mersim Dema, lindur më 1.4.1906.

KËRKUESJA
Sanije Shehu (Dema)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 28.9.2011
Doli nga shtypi më 30.9.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 64 lekë